



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 64, Datë 23.04.2019

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E “ENGLATINA XHOXHAJ” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “LUGANO”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, NË ZONËN SHEQ MARINAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE TOPOJË, BASHKIA FIER, QARKU FIER.

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”; nenit 5, pika 1 gërma “a”; nenit 10 pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr.109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.04.2019 mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për licencimin e “Englantina Xhoxhaj” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik “LUGANO” me kapacitet të instaluar 2 MW.

Konstatohet se:

- Personi fizik “Englantina Xhoxhaj” sh.p.k. me shkresën nr. 240 Prot, datë 21.03.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik “Lugano” me kapacitet të instaluar 2 MW.
- Znj. Englantina Xhoxhaj, e rregjistruar si Personi Fizik me vendimin të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 14331, datë 08.05.2000, bazuar në nenin 2 dhe 5 të Ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” i ndryshuar, është Mbajtës i Miratimit Përfundimtar me nr. 9310/2, datë 19.12.2018.
- Neni 37, pika 1 e Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë”, i ndryshuar, parashikon se : Çdo person juridik, që kryen një veprimtari në sektorin e energjisë elektrike, sipas pikës 2, të këtij neni, duhet të pajiset me licencën përkatëse, të lëshuar nga ERE, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.
- Për sa më sipër cituar, personi juridik Englantina Xhoxhaj sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 240/2, datë 08.04.2019, ka përcjellë sqarime lidhur me

aplikimin për licencë për Centralin Fotovoltaik “LUGANO” me kapacitet prodhues 2 MW, në zonën e Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.

- Në vijim të kërkesës për licencim, Englantina Xhoxhaj me shkresën e protokolluar në ERE nr. 240/1, datë 03.04.2019, ka bërë me dije ERE-n lidhur me ndryshimin e statusit juridik dhe krijimin e shoqërisë “Eglantina Xhoxhaj” sh.p.k. e rregjistruar në QKB me NUIS L92801402B, datë rregjistrimi 01.04.2019, me seli në Fier.
- Nga korrespondenca nr. 240/1, datë 03.04.2019, rezulton se, përveç ERE-s, personi juridik Englantina Xhoxhaj sh.p.k. ka bërë më dije për këtë ndryshim edhe MIE-n, AKBN dhe OSHEE sh.a..
- Neni 3 i ligjit nr. 9901 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” parashikon që: Shoqëritë tregëtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. **Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).**
- Në kuptim të sa më sipër, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Eglantina Xhoxhaj” sh.p.k, është themeluar nga personi fizik Englantina Xhoxhaj, mbajtëse e Miratimit Përfundimtar me nr. 9310/2, datë 19.12.2018, dhe Kontratës Nr. 6583 Rep dhe Nr.2075 Kol, datë 29.12.2018, të lidhur ndërmjet MIE dhe Personi Fizik “Englantina Xhoxhaj” *“Për Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Centralit Fotovoltaik “Lugano” me kapacitet prodhues 2 MW, në zonën Sheq Marinas, Topojë, Qarku Fier.*
- *Aplikimi i kryer nga personi fizik, themelues i personit juridik, i cili ka tagrin e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik “Lugano”, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:*
- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “b”, dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.4.3 gërmat “a”, “b”, “d”; 4.4.4 gërmat “b”, “c”, “d”; 4.5 gërma “a”, “b”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Shoqëria “Eglantina Xhoxhaj” sh.p.k kërkon nga ERE vijimin e procedurës së licencimit për prodhimin e energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik “LUGANO”, për subjektin “Eglantina Xhoxhaj” si sh.p.k. e rregjistruar në QKB me NUIS L92801402B, duke pretenduar se nuk ka ndryshuar aksioneri, por vetëm statusi i shoqërisë.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me :

- Nenin 9, pika 2, gërma “c”, “d”, “g” (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria) dhe gërma “e” (struktura e ndërtimit, lista e personelit sipas profilit në përputhje me aktivitetin);
- Nenin 9, pika 3 gërma “a” (vërtetim për shlyrjen e tatim-taksave) dhe pika “c” (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit).
- Nenin 9, pika 4.4.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin), do të njoftohet personi, që në bazë të nenit 11, pika 1, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*”, ti paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Do t’i kërkohet “Eglantina Xhoxhaj” që në vijim të depozitohet në ERE qëndrimin e MIE lidhur me njohjen e këtij ndryshimi të formës juridike të personit mbajtëse të Miratimit Përfundimtar me nr. 9310/2, datë 19.12.2018, dhe Kontratës Nr. 6583 Rep dhe Nr.2075 Kol, datë 29.12.2018, të lidhur ndërmjet MIE dhe Personi Fizik “Eglantina Xhoxhaj” “*Për Ndërtimin, Shfrytëzimin Dhe Administrimin e Centralit Fotovoltaik “Lugano” me kapacitet prodhues 2 MW, në zonën Sheq Marinas, Topojë, Qarku Fier.*

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e “Eglantina Xhoxhaj” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik “LUGANO”, të ndodhur në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, me kapacitet të instaluar 2 MW.
1. Drejtorja e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI